



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH**

DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT.

Nr 1335 prot

Gramsh, më 31.03. 2022

N J O F T I M

Bazuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1. dt.18/07/2012 Për “Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, të VKB nr.25 dt.28.02.2022 për miratimin e dhënies me qira të pasurisë nr.293/1 në fshatin Sult ,Njësia Administrative Sult , Bashkia Gramsh,dhe pasurisë nr. 1 në fshatin Dufshan ,Njësia Administrative Sult ,Bashkia Gramsh, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 273 dt .23 10. 2019. “ Për krijimin e komisionit për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara” njoftohen subjektet e interesuara për marrjen toke bujqësore me qira se procedurat e konkurimit do të zhvillohen, sipas orarit të mëposhtëm;
-Për pasurinë nr. 293/1 me sip.11250 m² e llojit arë, ZK 3546, fshati Sult,Njësia Administrative Sult , Bashkia Gramsh procedurat e konkurimit do të zhvillohen në orën 10.00 dt. 9 Maj 2022 ditën e Hënë.

Për pasurinë nr.1 me sip.21000m² e llojit arë,ZK 1560 në fshatin Dufshan ,Njësia Administrative Sult Bashkia Gramsh,procedurat e konkurimit do të zhvillohen në dt. 9 Maj 2022 ditën e Hënë ora 12 .00 .

Konkurimi do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Bashkisë Gramsh.

Dokumentat që do të sjellin çdo subjekt janë;

Të dhënat e kërkuarit,

Sipërfaqja dhe vendodhja e tokës bujqësore(hartë treguese ,kartelë pasurie) e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me nr. kadastral përkatës, të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me nr. e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme(ZVRPP);

3 - Afati i qirasë ;

4 - Projektin teknik ku të jenë përcaktuar;

Veprimitaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose llojet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimitari;

Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve;

Investimet kryesore mbi infrastrukturën(kullim ,ujitje ,sistemim etj. Të shprehura në tregues fizik e monetar si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve.

Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare ,ndikimin e investimeve në rritjen e numrit të punësuarve në bashkinë Gramsh,

5 - propozimin për çmimin e ofruar për marjen e tokës bujqësore me qira (lekë / ha në vit).

6 - Vërtetimin e lëshuar nga DAMT-ja e Qarkut Elbasan, ku tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral, si dhe jepet informacioni për gjendjen e pronësisë së saj.

Shënim; Dokumentat pranohen vetëm origjinale.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI
Klodian TACE

